




Pranimi / Doretzimi Priljezi/Protokolo Received/Delivery	21. 04 / 2021	1	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinstvo Org. /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prifeg Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSHIC/1927/2021			1/3



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.271/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.271/2021 të datës 15.04.2021, të parashtruar nga ankuesi _____ me adresë Drenas 2, në Komunën e Drenasit, kundër organit të punësimit/Komuna e Drenasit, në çështjen juridike “kontestim konkursi” duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 21.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur për ankesën me numër A.nr.271/2021 të datës 15.04.2021 të parashtruar nga ankuesi _____

A r s y e t i m

Ankuesi _____ me datë 15.04.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 1788/2021 të regjistruar me numër A.nr.271/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit për pozitën “Fotograf” të shpallur me datë 02.02.2021 nga Komuna e Drenasit.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 1788/2021 të regjistruar me numër A.nr.271/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Informimin përmes e-mailit të datës 08.04.2021 për ankuesin; Letër reference për dëshminë e punës e datës 10.03.2021; Ekstraktin e Regjistrimit Qendror të Gjendjes Civile të datës 11.02.2021; Dëshminë e datës 10.03.2021; Vërtetimin e kopjes nga dokumenti origjinal; Kërkesën për punësim të ankuesit; Diplomën e datës

02.12.2020; Konkursin e datës 02.02.2021 për pozitën "Fotograf"; Njoftimin e datës 15.04.2021 nga Komisioni për Shqyrtimin e Kërkesave, dhe E-mailin e datës 14.04.2021 të ankuesit për ankesa.kpmschck@rks-gv.net.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, duke shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, nuk është kompetent për vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi *sepse:*

Komuna e Drenasit, duke u bazuar në nenin 67 dhe 68 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, si dhe nenit 8 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, me datë 02.02.2021 ka shpall konkursin për plotësimin e pozitës "Fotograf".

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së pretendimeve ankimore, ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe si rrjedhojë ka konstatuar se pozita e punës "Fotograf" nuk hyn në kategorinë e pozitave të nëpunësve civil, por kjo pozitë hyn në kategorinë e nëpunësve të shërbimit publik siç parashihet me nenin 2 paragrafi 4 të këtij ligji, ku përcaktohet se: *Nëpunës i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike.* Rrjedhimisht, Kolegji konstaton se mbi këtë bazë ligjore edhe është shpallur konkursi i datës 02.02.2021 për pozitën e punës "Fotograf" në Komunën e Drenasit.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil, si dhe duke marr parasysh konstatimin se ankuesi nuk e ka statusin e nëpunësit civil apo kandidatit për pranim në Shërbim Civil, Kolegji konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.271/2021 të datës 15.04.2021 të parashtruar nga ankuesi

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, bazuar në dispozitat e nenit 24 dhe 74 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konstaton se zyrtarët publik me status të nëpunësit të Shërbimit Publik apo kandidate për pranim në Shërbimin Publik, kanë të drejtë të ankohen të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojnë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore



në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.271/2021

Avdyll BEKTESHI

Avdyll Bekteshi
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Drenasit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Drenasit dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;

